

Kërkimi shkencor – Dep. Arkitekturës dhe Dizajnit

Departamenti i Arkitekturës dhe Dizajnit në Universitetin Barleti ka përditësuar strategjinë e kërkimit shkencor për të bërë të mundur përfundimin e ndërkombëtarizimit, zhvillimit të projekteve dhe kërkimit shkencor, si edhe në vazhdim të përvojës së suksesshme.

Në departament kërkimi shkencor është gjithashtu në funksion të rritjes cilësore të mësimdhënies e mësim-nxënies nëpërmjet ngritjes së kualifikimit dhe ekspertizës së stafit akademik, transferimit të arritjeve bashkëkohore në fushën e shkencës tek studentët si dhe përfshirjes së këtyre të fundit në veprimtari kërkimore. Ekspertiza e secilit nga anetarët e këtij departamenti ka një gjithëpërfshirje të gjërë në fushën e arkitekturës, inxhinierisë, urbanistikës. Projektet janë kërkimore shkencore dhe projekte aplikative.

- Projektit Reehub plus është një projekt që filloi në shtator të 2020 dhe përfundon në shkurt të 2022. Ka për qëllim që metodologjinë e Auditit të identifikuar dhe publikuar gjatë projektit Reehub, ta përdore më gjërësisht për të realizuar performancën e energjisë në ndërtesa publike.
- Projekte arkitektonike të ndryshme në bashkëpunim me Institutet Bird, Adriapol, Vistas kryesisht Kampusi i ri Universiteti Barleti, (në vazhdim) (Ark. Oltjon Luga, Dr. Ark. Otjela Lubonja).
- Rikonstruksione shkollash nëpër rrethë të ndryshme si Mamurras, Durrës, Krujë, Vore.etj. përgatitje preventivash dhe ndërhyrje arkitektonike. (Ark. Oltjon Luga, Dr. Otjela Lubonja, Ark. Ajda Carcani).
- Krijimi i studios se re ArkiLAB ne Universitetin Barleti ne bashkepunim me departamentin e Arkitektures dhe Dizajnit e Institutet.(Ark. Oltjon Luga , Dr. Ark. Otjela Lubonja , *Studentet*: Glen Jaho, Marsela Hushi).

